



Në mbështetje të nenit 14 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5., nenit 19, nenit 48 paragrafi 1, nënparagrafi f) g) j) dhe nenit 49 paragrafi 1, nënparagrafi a) të Rregullores Disiplinore të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), Komisioni Disiplinor i FBK-së, pas zhvillimit të procedurës disiplinore mori këtë

V E N D I M

- I. Gent Shala, lojtar i KB Grapeland, për shkelje të rëndë disiplinore, i shqiptohet masa disiplinore: "Ndalesë loje për një periudhë prej gjashtë (6) muaj".
- II. Masa sipas pikës I të këtij vendimi do të bartet në sezonin e ri të garave dhe do të ketë efekt ndalese për lojë të zhvilluara në kuadër të garave të organizuara nga FBK.
- III. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Komisioni Disiplinor (këtu e tutje Komisioni) nëpërmjet postës elektronike, më datën 29.04.2024, ka pranuar email nga sekretarja e përgjithshme, znj. Elvira Dushku, në të cilin ka gjetur të bashkëngjitur Vendimin me nr. prot 07/2024 të Komisionit të Garave për iniciimin e procedurës disiplinore, ndaj Gent Shala, lojtar i KB Grapeland, të cilin e ka bazuar në nenin 52.17 të Propozicioneve të Garave për Kategoritë Seniore, Edicioni 2023/2024. Bashkë me vendimin përkatës, komisioni ka pranuar edhe provat materiale që kanë të bëjnë me rastin në fjalë, respektivisht Procesverbalin e Komisionit të Garave të datës 12.04.2024, Informatorin Nr. 23/2024 dhe Informatorin Nr. 19/2024.

Ashtu siç përcaktohet me aktet në fuqi, Komisioni, më qëllim që menjëherë të filloj me shqyrtimin e fakteve dhe provave në procedurën disiplinore, me datën 02.05.2024, në orën 16.30, në lokalet e FBK-së, ka mbajtur takimin e parë shqyrtues, me ç' rast ka dizajnuar administrimin e procesit për të vlerësuar faktet dhe rrethanat e ngjarjes që janë të nevojshme për marrjen e vendimit. Në kuadër të këtij takimi, Komisioni, në përbërje të plotë dhe aprovim të të gjithë anëtarëve vendosi që për qëllime të verifikimit të fakteve dhe në zbatim të drejtë të Rregullores Disiplinore të FBK-

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



BUP FINANCE JOINT VENTURE

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball Supporters:





së, duke zbatuar nenin 38 të Rregullores Disiplinore, nëpërmjet shërbimeve të sekretarisë të FBK-së, për t'u njohur me variantin e ngjarjes apo të problemit, palëve të përfshira në këtë rast t'u kërkohet që të deklarohen më shkrim.

Në funksion të trajtimit të lëndës, përveç takimit të datës 02.05.2024, Komisioni është takuar edhe më datën 10.05.2024. Në takime kanë qenë prezent: Fidan Hamiti – kryetar (prezent në të gjitha takimet), Afrim Kamishi – anëtar, Omer Daku – anëtar si dhe në përputhshmëri me nenin 36 të Rregullores Disiplinore, prezent kanë qenë edhe zyrtarë të FBK-së, Adriatik Rraci, zëvendëssekretar i FBK-së dhe Enea Hajdari, këshilltare ligjore për sport e FBK-së.

Më datën 08.05.2024, Komisioni, nëpërmjet email-it, nga shërbimet e sekretarisë të FBK-së, sipas kërkesës, ka pranuar deklaratat të ndara nga palët si në vijim:

1. Gent Shala, basketbollist i KB Grapeland,
2. Mehdi Gashi, vëzhgues i ndeshjes,
3. Xhelal Mumini, gjyqtar i ndeshjes dhe
4. Artan Kera, gjyqtar i ndeshjes.

Sipas leximit të provave shkresore të dosjes së lëndës, Komisioni iu kishte dhënë mundësi të përfshirëve që në lidhje me rastin në fjalë, ta deponojnë një deklaratë të re, apo sipas vlerësimit të tyre qëndrojnë prapa asaj që kishin deklaruar në kuadër të paraqitjes para Komisionit të Garave (shih procesverbalin e Komisionit të Garave me nr. prot. 04/2024, 11.04.2024). Gjyqtarët si më lart dhe vëzhguesi i ndeshjes, në shkresa të ndara kanë konfirmuar që qëndrojnë prapa deklaratave të dhëna para Komisionit të Garave, të konstatuara si në procesverbalin përkatës, përderisa pala ndaj të cilit është iniciuar procedurë disiplinore ka dhënë deklaratë me shkrim të cilën Komisioni do ta paraqesë në artikullimin e më poshtëm.

Komisioni duke lexuar provat shkresore në dispozicion, ka kuptuar se kemi të bëjmë me dyshime të bazuara se Gent Shala, lojtar i KB Grapeland, fillimisht kanosur dhe më pastaj ka realizuar sulmit fizik, kundrejt gjyqtarit Artan Kera, në kuadër ndeshjes të Ligës së Dytë Meshkujt, Play Off – Finale ndeshja II-të, e zhvilluar me datë 03.04.2024, mes të KB Grapeland dhe KB KEKU, siç është konstatuar në procesverbalin e Komisionit të Garave, me çrast, për efekt të arsytimit të vendimit, Komisioni ka shkëputur pjesë të tekstit pa ndërhyrje:

Pjesë e deklaratës së z. Mehdi Gashi, e konstatuar në procesverbal:

Kosovo Basketball Federation

Supported by:

General Sponsor:



BP PARASO JOINT VENTURE

Golden Sponsors:

Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball Supporters:





- Vëzhguesi shpjegoi se pas diskualifikimit të lojtarit, lojtari ka hezituuar të largohet nga parketi duke i thënë vëzhguesit ‘...vetëm sa të kryhet ndeshja, se kom me ja bo kështu kështu referit...’
- Z. Gashi tregon se ai i ka paralajmëruar edhe policët civil që të kenë kujdes dhe të mos e lënë vetëm gjyqtarin Kera.
- Pas përfundimit të ndeshjes, lojtari Shala është nisur në drejtim
- të gjyqtarit Kera dhe e ka goditur me kokë në ball;

Pjesë e deklaratës së z. Artan Kera, e konstatuar në procesverbal:

- Lojtari ka vazhduar me sjellje jo-sportive dhe gjyqtari Mumini e ka përjashtuar me gabim diskualifikues diku 3 minuta para përfundimit të ndeshjes.
- Kera shprehet se me përfundimin e ndeshjes lojtari ‘...ka ardh me vrull në drejtim timin dhe m’i ka kapur duart, më ka godit me kokë, pastaj ka ardh edhe Xhelali dhe policia me na nda përfundimisht, e në fund edhe i kemi dhënë deklaratat në polici...’

Pjesë e deklaratës së z. Xhelal Mumini, e konstatuar në procesverbal:

- Mumini shprehet: ‘... me përfundimin e ndeshjes unë kam qenë te tavolina zyrtare ndërsa Kera tek koshi; unë se kam pa goditjen, vetëm e kam pa pjesën e ënjtur dhe të kuqe në ballin e Kerës, e menjëherë, në mënyrë mjaft të vrazhdë, e kam shty lojtarin Shala për t’a larguar nga Kera...’
- Ai vazhdon të tregojë se pastaj edhe shikues nga tribuna kanë hyrë në parket duke i’u drejtuar lojtarit Shala, me ç’ rast Mumini është munduar të mbrojë edhe lojtarin, i cili iu drejtua me fjalët "çka bana, m.. e bana, mytëmni se m.. e bana".

Pretendimet e gjyqtarëve dhe të vëzhguesit të ndeshjes, i ka konfirmuar edhe vet pala ndaj të cilit është iniciuar procedurë disiplinore, nëpërmjet deklaratës së tij të deponuar në FBK (teksti pa ndërhyrje): “Unë, Gent Shala, përfaqësues i ekipit Grapeland në finalen e Ligës së Dytë, me këtë deklaratë, dëshiroj të shpreh keqardhjen time për veprimin që kam kryer gjatë ndeshjes dhe për ndikimin që kjo ka pasur në imazhin e sportit dhe ekipit tonë.

Situata në sallë ishte e vështirë dhe e stresueshme për të gjithë ekipin tonë, pasi që ne sallë ishin te pranishëm më shumë se 500 njerëz. Tensionin ishte i madh dhe ekipa kundërshtarë po shfrytëzonte gabimet e referimit kundër nesh, duke shtuar më shumë presionin dhe tensionin në fushë. Vendimet e njeanshme të gjyqtarëve ishin të vështira për të injoruar dhe shiheshin në çdo pike të ndeshjes. Kjo çoi në një ndjesi të pashpresë dhe në rritjen e frustrimeve te ne si lojtarë. Mungesa e përgjigjeve të gjyqtarëve ndaj

Kosovo Basketball Federation

Supported by:

General Sponsor:



BNP PARIBAS JOINT VENTURE

Golden Sponsors:

Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball Supporters:





pyetjeve tona për situata specifike në lojë tregon mungesën e profesionalizmit dhe respektit ndaj ekipit tonë. Kjo situatë shtoi edhe më shumë tensionin dhe ndjenjën e mosrespektimit të të drejtave tona si lojtarë”.

Në kuadër të shqyrtimit të deklaratave dhe dokumenteve të tjera, të cilat janë pjesë e dosjes së lëndës, Komisioni ka gjetur prova të mjaftueshme të cilat e konfirmojnë faktin se Gent Shala ka kanosur dhe ka realizuar sulm fizik ndaj gjyqtarit Artan Kera, shkelje e cila dënohet më aktet përkatëse të FBK-së.


Megjithatë, Komisioni duke u ndërlidhur më frymën e Rregullores Disiplinore të FBK-së, e cila promovon faktin se dënimet kanë karakter edukues, parandalues dhe korrigjues, dhe shqiptimi i tyre do të ketë gjithmonë qëllimin e mbrojtjes së interesit të përgjithshëm dhe vlerave të sportit të basketbollit, ka marrë për bazë edhe rrethanat lehtësuese të cilat tregojnë se qëllimi i dënimit mund të arrihet me një dënim më të butë dhe rrjedhimisht ka marrë në konsideratë shqiptimin e një dënimi më të ulët se ai i paraparë me Rregulloren përkatëse, veçanërisht kur në rastin konkret kemi të bëjmë me pranimin e fajësisë nga kryerësi i veprës. Gjithashtu peshë në vendimmarrje ka pasur edhe fakti se nga evidencat e FBK nuk është gjetur ndonjë fakt që ndaj të njëjtit është zhvilluar ndonjëherë procedurë disiplinore. Si dhe, në matje të dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat ndikuese të cilat lidhën më rrethanat në të cilat është kryer shkelja, sjellja e të përmendurit para dhe pas shkeljes, vetitë morale dhe qëndrimi i tij i shprehur në deklaratën e deponuar nga ai.

Andaj, Komisioni ka analizuar provat shkresore, përfshirë këtu edhe deklaratat e të gjitha palëve, ka ndërlidhur ato në mes veti, si dhe ka krahasuar me dispozitat e Rregullores për Procedurat Disiplinore të FBK-së dhe ka ardhur në përfundim se Gent Shala, lojtar i KB Grapeland, si rezultat i kanosjes dhe realizimit të sulmit fizik kundrejt gjyqtarit Artan Kera, në rrethanat e konsideruara si më lart, kanë kryer shkelje të rëndë disiplinore dhe rrjedhimisht vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR :


Omer Daku, anëtar


Fidan Hamiti, kryetar


Afrim Kamishi, anëtar

Prishtinë, 27.05.2024



Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball Supporters:





Vendimi t'u dërgohet:

- Gent Shala,
- Gjyqtarëve të përmendur,
- Vëzhguesit të ndeshjes,
- Anëtarëve të Komisionit Disiplinor të FBK-së dhe
- Arkivit të FBK-së.

KËSHILLË JURIDIKE:

Konform Nenit 42 të Rregullores Disiplinore, kundër vendimit të Komisionit Disiplinor të shkallës së parë mund të parashtrahet ankesë në afat prej 3 ditë (pune), duke llogaritur nga dita e përcjelljes së vendimit përmes postës elektronike, kurse i paraqitet Komisionit të Arbitrazhit të FBK-së. Me rastin e paraqitjes së ankesës, paraqitësi duhet të paguaj në llogari të FBK taksën në shumën prej 300 €, mjete të cilat i kthehen paraqitësit nëse i miratohet ankesa.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball Supporters:

